

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR " GT Alb Construction " SHPK

AKTI I THEMELIMIT

Hyrje

Në Durrës, sot më datë 05/11/2025 unë i nënshkruari Mariglent Tomja, shtetas shqiptar, atesia Ramazan, memesia Margaria lindur më 13/09/1986, në Kovashice Diber dhe me banim në adresën rruga Lagjia 13, Rruga Pavaresia, Rrota e Kuqe, Durrës, i pajisur me pasaportë nr. BD2102175 dhe ID I60913010V, madhor me zotësi juridike për të vepruar, në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, krijova shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **" GT Alb Construction " SH.P.K.** përpilojmë këtë statut si më poshtë:

KREU I PARË

Pjesa e
përgjithshme

Neni1

Ortaku me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të japin kontributet e tyre sipas përcaktimeve që parashikohen në këtë statut për arritjen e objektivave ekonomike duke destinuar në një sipërmarrje pasuri të tij me qëllim që të ndajën fitimin ose që të mund të përfitojnë nga të ardhurat që rrjedhin prej saj.

Neni 2

Emertimi dhe Forma e Shoqërisë

1. Shoqëria tregtare është e organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mban emërtimin: **" GT Alb Construction " SHPK**
2. Ajo është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shenim i cili ka të bëjë me transferimin.

Neni3

Periudha e veprimtarisë, perballimi i humbjeve të
shoqërisë

1. Shoqëria tregtare **" GT Alb Construction " SHPK** do të përmbushë objektin veprimtarisë së vet me një afat të pacaktuar kohe. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm, sipas rregullave të parashikuara në këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.



Neni 4

Selia, pjesemarrja ne shoqeri te tjera, vula dhe logo

1. Shoqeria tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise ne qytetin e Tiranese adresen: **Njesia Bashkiake nr 7, rruga Besim Imami, nd 16 H1** Kodi Postar .
2. Shoqeria tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK, ka marre masa per te patur nje adrese interneti si dhe nje poste elektronike per komunikim Email: **financatpc@gmail.com**, Nr.tel.+**393665055920**. Keto adresa do te jene te vlefshme per te tretet vetem pasi t'i jene njoftuar Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me piken 2 te nenit 69 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
3. Shoqeria krijon qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjere te Shqiperise ose jashte vendit.
4. Ajo mund te jete pjesemarrrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
5. Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendren e vet.
6. Shoqeria do te kete vulen e saj dhe logon e saj. Me Vendim te Ortakut te Vetem, vula e shoqerise dhe logoja mund t'i raportohen Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni5

Personaliteti Juridik

1. Shoqeria tregtare "**GT Alb Construction**" SHPK, duke qene se eshte e regjistruar prane Regjistrimit Tregtar, gezon personalitet juridik ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
2. Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

Neni 6

Objekti i Veprimtarise

Shoqeria tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK ka si objekt te veprimtarise se saj:

- **Veprimtari per projektim dhe ndertime e rikonstruksione te veprave industriale e sociale, banesash shume kateshe dhe vilash, veprash urbane, rruge e kanalizime, sherbime publike per panaire e ekspozita. Import-eksport dhe tregeti me shumice e pakice i materialeve te lendeve te para per ndertim,te gjitha llojet e inerteve qe prodhohen prej guri,çdo material apo lende e pare qe perdoret ne ndertime, Akuakultura,ne fushen e riciklimit te gomave ,ne fushen energjitikes etj. Tregti vajra lubrifikant me pakicë. Ndertim rrjetesh ujesjellesa te furnizimit me uje,ndertim impiantesh te ujit te pishem dhe pastrimit te tij,pastrimit te ujerave detare, liqenor dhe lumor. Ndertim rrjetesh gazsjellesa. Punime topogjeodezike, mjedisi, nentoksore, ura e vepra arti, veshje fasadash, rifiniture murature, druri, material plastike, xhami, punime per prishjen e ndertimeve. Ndertim digash,vepra kullimi etj.**

GT Alb Construction

Neni 7 Pergjegjesia e Shoqerise

Shoqeria tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaku zhvillon ne menyre te pavarur prej saj.

NENI 8 Kapitali Themeltar, pjesemarrja

1. Shoqeria tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK, ka nje kapital themeltar ne vleren prej 100 (njqind) Leke, e cila zoterohet teresisht nga ortaku i shoqërisë dhe e ndare ne 1 (nje) kuote.
2. Pjesemarrjet e ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise janë si më poshtë :
 - Mariglent Tomja 100(njqind) Leke, perkatesisht 1 (nje) kuote.
3. Ky kapital perbehet nga nje kuote te barabarta me 100(njqind mije) Leke.

KREU II Shperndarja e fitimeve


Neni 9 Menyra e shperndarjes se fitimeve

1. Ne baze te pjesemarrjes se kapitali themeltar ne shoqeri, fitimi i shperndahet ortakut te vetem ne raport me kuotat e zoteruara. Keto fitime i shperndahen ortakut te veten, vetem nese pas pagimit te dividendit :
 - a) Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
 - b) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve.
2. Ne rast te plotesimit te kushteve te siperpermendura ne kete nen, nga ana e administratorit te shoqerise leshohet nje gertifikate qe tregon aftesine paguese te shoqerise. Ne te kundert nje gertifikate e tille nuk mund te leshohet. Leshimi i nje certifikate te tille ne kundërshtim me kete nen, ngarkon administratorin me pergjegjesi.
3. Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci i miratuar nga ortakët do te shperndahen si vijon :
 - a) 5% per fondin rezerve, deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar;
 - b) pjesa tjeter i shperndahet ortakëve ne raport me pjesemarrjen e tij ne kapitalin themeltar.

Neni 10 Fondi rezerve

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veganta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar. Krijimi i nje fondi te tille, behet gjithmone me vendim te Ortakëve.

Neni 11

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i Cdo fondi te vecante percaktohen nga organi perkates sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
- 

GT Alb Construction

2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi <do operacion financiar i saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

Neni 12

1. Shoqeria tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ate ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhet nga fondet e shoqerise.

Neni13

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim te Ortakut te Vetem.

KREU III

Transferimi i Kapitalit

Neni14

Transferueshmeria e kapitalit

1. Kuotat kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.
2. Personi qe e fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes se ortakut gezon te drejtat e titullarit te cilat do ti kishte ai. Por ama me perjashtim te faktit qe perpara se te realizohet ky regjistrim i kuotes duhet patjeter te behet dorezimi perkates.

Neni 15

Transferimi me ane te trashegimise

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbytjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me

gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

GT Alb Construction

Neni 16

Transferimi i kuotave tek personat e trete

1. Ne rast mospranimi pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin nga Ortaket.
2. Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim, prane nje noteri dhe i njoftohet shoqerise.
3. Transferimi i tyre, merr vlere vetem pas regjistrimit te kalimit te kuotave prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

KREU IV

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Neni 17

1. Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne natyre apo zvogelimi i tij behet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar dhe me kerkesen qofte edhe te njerit prej ortakeve themelues.
2. Zvogelimi i kapitalit themeltar, behet ne baze te dispozitave te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 18

Zmadhimi i Kapitalit

1. Ortaket, mund te vendosin qe rritja e kapitalit te behet dhe me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te cilat figurojne deri ne daten 31 dhjetor te vitit/viteve financiar/financiare paraardhes/paraardhese. Kjo gje behet vetem pasi Ortaket, me vendim te kete miratuar llogarite vjetore te shoqerise per vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhes /paraardhese.
2. Pas marrjes se nje vendimi te tille, Ortaket caktojne nje Ekspert Kontabel te Regjistruar per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31 dhjetor te vitit paraardhes.
3. Pas prezantimit te aktit te vleresimit nga Eksperti Kontabel i Regjistruar, ortakët e shoqerise, me nje vendim tjeter, percakton menyren e rritjes se kapitalit themeltar te shoqerise.
4. Pas marrjes se vendimit te dyte nga Ortaket, e gjithë procedura e ndjekur ne zbatim te ketij neni do te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit sipas parashikimeve te Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

KREU V

Ortakeria

Neni 19


Ortakeria per shoqerine tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK krijohet dhe mbeshtetet ne Statutin e kesaj shoqerie dhe ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 20

Shoqeria Tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK, ka vetem nje ortak, te drejtat dhe detyrimet e te cilit percaktohen ne kete statut dhe ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 21

Ortakët e shoqerise tregtare " **GT Alb Construction** " SHPK gezojne te gjitha te drejtat dhe merr persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise, dhe ne Statutin e shoqerise.



GT Alb Construction

Neni 22

- Te drejtat dhe detyrat e ortakëve;
- Te marre pjese ne mbledhjet e Ortakëve;
- Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise;
- Te informohet mbi permbajtjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, e raportin e ekspertit kontabel;
- Te perfitoje nga fitimi i shoqerise;
- Te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara;

KREU VI

Organizimi i shoqerise

Neni 23

Strukturat Drejtuese dhe Vendimmarrese

Shoqeria tregtare "GT Alb Construction" SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendim marrese :

Ortakët si organi vendimmarres per shoqerine dhe
Administratorin

Neni 24

Detyrat dhe Pergjegjesite e Organit Vendimmarres

1. Ortakët, si organ vendimmarres per shoqerine, jane pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
 - f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
 - j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Ortakët marrin vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "e" te pikes "1" te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
3. Te gjitha vendimet e marra nga ortakët do te regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Forma e regjistrimit dhe mbajtja e vendimeve percaktohen me vendim te ortakëve. Ortakët, me vendim, mund te ngarkojne dhe nje person fizik per mirembajtjen e regjistrimit te mbledhjeve.
4. Nga ana e Ortakëve merren te gjitha masat perkatese per regjistrimin e vendimeve te saj prane organeve perkatese shteterore dhe sidomos ne vecanti, vendimet per:

GT Alb Construction

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- e) vendimet e marra ne zbatim te nenit 18 te ketij statuti.

5. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria

nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni25

Mbledhja e Organit Vendimmarres

1. Mbledhja e Ortakëve zhvillohet ne rastet e percaktuara nga Ligji Nr. 9904 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e ortakut te vetem thirret dhe zhvillohet te pakten nje here ne vit.
2. Mbledhja e Ortakëve thirret nga kryesisht nga ortakët , administratori apo dhe nga Eksperti Kontabel i Regjistruar kur ka nevojë per diskutime per ceshtje ekonomike qe lidhen me shoqerine.
3. Mbledhja e Ortakëve thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
4. Mbledhja e Ortakëve thirret nga personat e tjere te parashikuar nga pika 2 e ketij neni jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar ne mbledhjen e Ortakëve. Menyra e thirrjes se Asamblese behet sipas percaktimeve perkatese te parashikuara ne nenin 83 te Ligjit Nr. 9904 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni26

Administrimi, Detyrat e Administratorit

1. Administrimi i shoqerise "**GT Alb Construction**" SHPK kryhet nga Administratori. Administratori mund te jete person dhe person fizik jashte shoqerise.
2. Administrator i shoqerise i emeruar do te jete z. **Mariglent Tomja**, shtetas shqiptar, atesia Ramazan, memesia Margaria lindur më 13/09/1986, në Kovashice Diber dhe me banim në adresen rruga Lagjia 13, Rruga Pavaresia, Rrota e Kuqe, Durrës, i pajisur me pasaporte nr. BD2102175 dhe ID I60913010V, madhor me zotësi juridike për të vepruar, me nje mandat **pesëvjecar, nga data 05 Nentor 2025 deri me 04 Nentor 2030.**
3. Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:
 - a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
 - b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
 - c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
 - d) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Ortakëve per miratim;

GT Alb Construction

- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si9 parashikohet ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- e) raportoje perpara Ortakëve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e)perfaqesoje shoqerine ne marredhenie mete tretet;
- f)kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni27

Pergjegjesia e Administratorit

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Neni 28

Eksperti Kontabil i Regjistruar

1. Shoqeria Tregtare " GT Alb Construction " SHPK emeron Ekspert Kontabel te Regjistruar.
2. Emerimi kryhet nga Ortakët.
3. Per kompetencat, detyrimet, pergjegjesite, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 29

Punesimi ne Shoqeri

Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale apo kolektive, sipas rastit, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.

KREU VII

Bashkimi dhe ndarja e shoqerise

Neni 30

1. Shoqeria " GT Alb Construction " SHPK me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne qe ushtron te njejtin aktivitet.
2. Gjithashtu shoqeria " GT Alb Construction " SHPK me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.
3. Ne rast se operacioni perfshin krijimin e shoqerive te reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave qe i perkasin shoqerise qe do te krijohet.
4. Transferimi i plote i aktivitet te shoqerise apo kontributi ne aktiv te nje shoqerie tjeter, ver;anerisht me ane te procesit te bashkimit duhet te autorizohet nga Ortakët

GT Alb Construction

KREU VIII Prishja dhe likuidimi i shoqerise

Neni 31

1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.
2. Shoqeria hyn ne fazen e likuidimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortaket emerone nje ose disa likuidatore, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Shoqeria priset ne keto raste:
Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilin eshte krijuar shoqeria
Me vullnetin e ortakeve
• Me vendim te Gjykates
• Shkaqe te tjera te parashikuara ne ligj

Neni 32 Procedura qe ndiqen

1. Likuidimi i shoqerise tregtare "GT Alb Construction" SHPK vendoset nga Ortaket kur priset shoqeria.
2. Likuidimi i shoqerise do te behet duke zgjedhur proceduren e zakonshme te parashikuar ne nenet 192 -203 te Ligjit Nr. 9901 date 14. 04. 2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni33

1. Ne qofte se Ortaket, per mbylljen e parashikuar, nuk mund te marre vendim ose ata nuk pranojne te miratojne llogarite e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kerkesen e likuiduesit ose cdo personi te interesuar.
2. Nese nuk eshte proceduar si me siper Gjykata me miratimin e Ortakeve zbaton dispozitat ligjore dhe ne se miratimi nuk eshte dhene deri ne seancen e pare gjyqesore ky miratim prezumohet i mireqene.

Neni 34

Ne fund te procesit te likuidimit thirren Ortaket per te vendosur ne lidhje me bilancin financiar perfundimtar.

KREUIX DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 35

1. Te gjitha mosmarreveshjet dote zgjidhen me ane te dispozitave te ketij statuti.
2. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohet Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni36

Ky Statut perpilohet ne 4 (kater) kopje origjinale secili me te njejten vlerë ligjore. Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË

Mariglent Tomja

MARIGLENT TOMJA

[Signature]